



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.91	2005	1 dhjetor
--------------	-------------	------------------

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.679, datë 2.11.2005	Për një shtesë në vendimin nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave “Për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	2907
Vendim i KM nr.682, datë 2.11.2005	Për shpalljen e lumit Buna dhe të territoreve ligatinore përreth tij “Peizazh ujor/tokësor i mbrojtur”.....	2907
Vendim i KM nr.683, datë 2.11.2005	Për shpalljen e kompleksit ligatinor të liqenit të Shkodrës e të zonës së lumit Buna, zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur, dhe përfshirjen e tij në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht, si habitate të shpendëve ujorë....	2910
Vendim i KM nr.684, datë 2.11.2005	Për shpalljen e zonës shqiptare të liqenit të Shkodrës “Rezervat natyror i menaxhuar”.....	2912
Vendim i KM nr.693, datë 10.11.2005	Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit “Park Kombëtar”.....	2913
Vendim i KM nr.694, datë 10.11.2005	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugës, në lagjen Granicë, në bashkinë e Gjirokastrës.....	2915
Vendim i KM nr.695, datë 10.11.2005	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë arë), që preken nga ndërtimi i varrezave publike në qytetin e Elbasanit.....	2916
Vendim i KM nr.702, datë 10.11.2005	Për përzgjedhjen e organizatave të punëdhënësve dhe të sindikatave më të përfaqësuara në këshillin administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.....	2918
Vendim i KM	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të	

nr.707, datë 16.11.2005	paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV, Burdullias, Berat.....	2918
Urdhër i MF nr.6, datë 25.11.2005	Për sekuestrimin e asetëve të shtetasit jordanëz Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si: a) Abdyl Latif A.A. Saleh, b) Abdyl Latif Saleh, c) Dr. Abd al-Latif Saleh, d) Abdyl Latif A.A. Saleh Abu Hussein, e) Abd al-Latif Salih, f) Abu Amir.....	2919
Vendim i GJK nr.24, datë 26.10.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.412, datë 23.6.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	2922
Vendim i GJK nr.25, datë 28.10.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.1446, datë 13.7.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën.....	2925
Vendim i GJK nr.26, datë 2.11.2005	Me objekt shfuqizimin e nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, si antikushtetues.....	2927
Vendim i GJK nr.27, datë 4.11.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.1392, datë 15.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr.138, datë 21.3.2000 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr.278, datë 20.3.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.2, datë 28.1.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese	2930
Vendim i GJK nr.28, datë 9.11.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.3345, datë 16.7.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.6, datë 13.1.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1507, datë 15.7.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	2932
Vendim i GJK nr.29, datë 9.11.2005	Me objekt shfuqizimin e nenit 34/1 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	2934

VENDIM
Nr.679, datë 2.11.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.439, DATË 4.8.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË“, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 9 të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr.8 “Praktika e lëshimit të vizës në Republikën e Shqipërisë”, në listën “Vendet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa vizë, duke paguar taksën e hyrjes (kur udhëtojnë me pasaporta të thjeshta)”, të vendimit nr.439, datë 4.8.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen shtetet:

“- Qipro;

- Maltë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.682, datë 2.11.2005

PËR SHPALLJEN E LUMIT BUNA DHE TË TERRITOREVE LIGATINORE PËRRETH TIJ
“PEIZAZH UJOR/TOKËSOR I MBROJTUR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 13 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Peizazh ujq/tokësor i mbrojtur” të zonës së lumit Buna, së bashku me deltën dhe ishullin e Franc Jozefit, rezervatin e Velipojës, lagunën e Vilunit, plazhin e Baks-Rrjollit, kënetën e Domnit, si dhe territoret përreth tyre, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Peizazhi ujq/tokësor i mbrojtur kufizohet:

Nga veriu: Me vijën që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri në kufirin verior me Republikën Serbi-Mali i Zi (koordinatat 42° 03’08” 19° 29’30”, 42° 01’31” 19° 29’, 42° 00’36” 19° 25’7”, 42° 00’ 19° 23’45”);

Nga perëndimi: Me vijën e kufirit shtetëror përgjatë lumit Buna me Republikën Serbi-Mali i Zi;

Nga lindja: Me vijën që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri te Rëra e Hedhur dhe që kalon nga zona malore (koordinatat: 41° 50’30” 19° 35’30”, 42° 53’15” 19° 30’, 41° 59’30” 19° 31’30”, 42° 00’ 19° 31’33”, 42° 02’15” 19° 30’, 42° 03’08” 19° 29”).

Nga jugu: Me vijën bregdetare nga Rëra e Hedhur deri te grykëderdhja e lumit Buna (koordinatat: 41° 50’57” 19° 23’, 41° 51’28” 19° 27’30”, 41° 50’58” 19° 30’.

3. Peizazhi ujq/tokësor i mbrojtur i lumit Buna ka një sipërfaqe të përgjithshme 23 027 ha, të përbërë nga:

a) sipërfaqe pyjore dhe shkurre

7 799” ha;

b) sipërfaqe lagunore	346	ha;
c) duna ranore, bregdetare	496	ha;
ç) toka të kripura	252	ha;
d) sipërfaqe të tjera (toka bujqësore, zona të banuara)	14 134	ha.

4. Peizazhi ujor/tokësor i lumit Buna ka zonimin e mëposhtëm, që paraqitet në hartën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4.1 Zona qendrore (zona A)

A.1 Zonë qendrore (në hartë e shënuar me 1a) e përbërë nga:

- a) pjesa e lumit Buna dhe brigjet e tij nga bashkimi me lumin Drin deri në fshatin Obot;
- b) brigjet e lumit Buna në pjesën perëndimore të rezervatit të Velipojës, nga grykëderdhja e lumit deri përballë skajit verior të ishullit Ada dhe 200 m në brendësi të rezervatit në lindje;
- c) ishulli i Franc Jozefit dhe bregdeti në lindje të grykëderdhjes, në gjatësi deri 2 km dhe gjerësi 300 m në det, drejt jugut;
- ç) pjesa qendrore dhe veriore e lagunës së Vilunit;
- d) gadishulli në plazhin e Baks-Rrjollit dhe një gjerësi 300 m në jug të vijës bregdetare deri te Rëra e Hedhur;

dh) pjesa qendrore e kënetave të Domnit dhe të Murtemzës.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”.

A.2 Zonë qendrore (në hartë e shënuar me 1b) e përbërë nga:

a) pjesa e lumit Buna në një gjatësi brigjesh 3 km në anën e djathtë të lumit, në veri të fshatit Oblikë;

b) pjesa e lumit nga fshati Obot (e kufizur në veri me pjesën e përmendur në pikën A.1 deri në pikën përballë skajit verior të ishullit Ada (e kufizuar në jug me pjesën e përmendur në pikën A.1), me një gjerësi 200 m drejt lindjes;

c) gjithë sipërfaqja e rezervatit të Velipojës, me përjashtim të asaj të përfshirë në pikën A.1 më sipër;

ç) pjesa jugore e lagunës së Vilunit (e mbetur nga pjesa e përfshirë në pikën A.1) dhe gjithë sipërfaqja kënetore, që rrethon brigjet e lagunës;

d) zona e Baks-Rrjollit, e mbetur nga pjesa e përfshirë në pikën A.1 deri në lartësinë 335 m në shpatin e malit Kolaj, në veri;

dh) pjesa e kënetave të Domnit dhe të Murtemzës, që rrethon atë të përmendur në pikën A.1.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”.

A.3 Zonë qendrore (në hartë e shënuar me 1c) e përbërë nga:

a) pjesa e lumit Buna, me gjatësi brigjesh 2 km, midis fshatrave Shirq dhe Obot, në anën e djathtë të lumit;

b) në gjatësi brigjesh 2 km të lumit Buna, në veri të fshatit Dajç, në anën e majtë të lumit.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”.

Zonë e zhvillimit tradicional (zona B)

B.1 Zonë e zhvillimit tradicional (në hartë e shënuar 2a) e përbërë nga:

a) fushat e Velipojës, me sipërfaqe 2500 ha;

b) fushat e Pentarit, me sipërfaqe 850 ha;

c) pellgjet (ish-vaskat e peshkut) e fshatit Reç, me sipërfaqe 114 ha;

ç) kullotat e Urës së Gjo Lulit dhe Domnit, me sipërfaqe 2200 ha.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, ku mund të ushtrohen veprimtari me karakter rikrijues, edukativ, ekoturistik, si dhe përdorimi tradicional i tokës, në harmoni të plotë me ruajtjen e natyrës dhe të vlerave shoqërore e kulturore të komunitetit vendas.

B.2 Zonë e zhvillimit tradicional (në hartë e shënuar me 2b) e përbërë nga: territori që fillon nga fshati Pentar, në kufirin me Malin e Zi, vazhdon përmes kënetave të lumit Buna e kodrave të Rrencit dhe zbret në bregdet te Rëra e Hedhur, e cilësuar si korridor migrimi.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë

6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, por për karakteristikat që ofron, kërkohen plane të veçanta menaxhimi.

C. Zonë e transicionit (zona C)

C. 1 Zonë e transicionit (në hartë e shënuar me 3) e përbërë nga: plazhi i Velipojës, i kufizuar në perëndim nga rezervati i Velipojës, në veri nga rruga automobilistike dhe me shtrirje, në lindje, deri në 500 m përpara kanalit të komunikimit të lagunës së Vilunit me detin.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes, në mbështetje të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”. Në këtë zonë mund të ushtrohen veprimtari bujqësore, si dhe mund të përdoret toka për qëllime të ndryshme turistike, sportive, edukative, rikrijuese etj., që nuk cenojnë natyrën dhe biodiversitetin, mbështetur në zhvillimin e qëndrueshëm dhe menaxhimin e burimeve natyrore të zonës.


5. Ngarkohet administrata ekzistuese e zonës së mbrojtur të Velipojës, e cila është në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të kryejë funksionet e administratës së peizazhit ujor/tokësor të mbrojtur të lumit Buna.

6. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, që në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, të hartojë rregulloren e administrimit dhe planin e menaxhimit të peizazhit ujor/tokësor të mbrojtur të lumit Buna.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha



VENDIM

Nr.683, datë 2.11.2005

PËR SHPALLJEN E KOMPLEKSIT LIGATINOR TË LIQENIT TË SHKODRËS E TË ZONËS SË LUMIT BUNA, ZONË NATYRORE VEÇANËRISHT E MBROJTUR, DHE PËRFSHIRJEN E TIJ NË LISTËN E LIGATINAVE ME RËNDËSI NDËRKOMBËTARE,

VEÇANËRISHT, SI HABITATE TË SHPENDËVE UJORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 e 4 të konventës “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë“, dhe të pikës 1 të nenit 13 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen zonë natyrore veçanërisht të mbrojtur dhe përfshirjen në listën e konventës “Ramsar”, “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht, si habitate të shpendëve ujorë“, të territorit natyror të kompleksit ligatinor të liqenit të Shkodrës dhe zonës së lumit Buna (përfshi deltën dhe ishullin e Franc Jozefit, rezervatin e Velipojës, lagunën e Vilunit, plazhin e Baks-Rrjollit, kënetën e Domnit), si dhe territoret përreth tyre, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kufijtë e kësaj zone janë:

Nga veriu: Pika kufitare e Hanit të Hotit ($42^{\circ} 20' 17''$ $19^{\circ} 26'$);

Nga perëndimi: Kufiri shtetëror përgjatë lumit Buna me Republikën Serbi-Mali i Zi;

Nga lindja: Rruga automobilistike Shkodër-Hani i Hotit dhe vija që bashkon daljen e lumit Buna nga liqeni i Shkodrës deri te Rëra e Hedhur dhe që kalon nga zona malore (koordinatat: $41^{\circ} 50' 30''$ $19^{\circ} 35' 30''$, $42^{\circ} 53' 15''$ $19^{\circ} 30'$, $41^{\circ} 59' 30''$ $19^{\circ} 31' 30''$, $42^{\circ} 00'$, $19^{\circ} 31' 33''$, $42^{\circ} 02' 15''$ $19^{\circ} 30'$, $42^{\circ} 03' 08''$ $19^{\circ} 29'$);

Nga jugu: Vija që bashkon grykëderdhjen e liqenit të Shkodrës me pikën kufitare dhe vija bregdetare nga Rëra e Hedhur deri te grykëderdhja e lumit Buna (koordinatat: $41^{\circ} 50' 57''$ $19^{\circ} 23'$, $41^{\circ} 51' 28''$ $19^{\circ} 27' 30''$, $41^{\circ} 50' 58''$ $19^{\circ} 30'$).

3. Zona ka një sipërfaqe prej 49 562 ha dhe ndahet në pesë kategori, sipas llojit të përdorimit të tokës, sipërfaqes së mbuluar me ujë dhe mbulesës bimore, që përcaktohet në:

- | | |
|---|------------|
| a) Sipërfaqe ujore | 15 719 ha; |
| b) Sipërfaqe lagunore | 346 ha; |
| c) Duna ranore, bregdetare | 496 ha; |
| ç) Sipërfaqe pyjore dhe shkurre | 9764 ha; |
| d) Toka të kripura | 252 ha; |
| dh) Sipërfaqe urbane, toka bujqësore, livadhe | 22 985 ha. |


4. Veprimtaritë ekonomike, që lejohen të ushtrohen në zonën “Ramsar” janë ato me karakter tradicional, që ruajnë vlerat mjedisore dhe që zhvillohen në përputhje me nivelin e mbrojtjes së zonës dhe me objektivat e planit të menaxhimit të saj.

5. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, me organizatat jofitimprurëse dhe me përfaqësues të komunitetit, të hartojë planin e menaxhimit të zonës.

6. Ngarkohen administratat e liqenit të Shkodrës dhe ajo e rezervatit të Velipojës, të realizojnë menaxhimin e zonës, në përputhje me planet e menaxhimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.684, datë 2.11.2005

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SHQIPTARE TË LIQENIT TË SHKODRËS “REZERVAT
NATYROR I MENAXHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 shkronja “ç”, 13, pika 1, e 23 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës shqiptare të liqenit të Shkodrës “Rezervat natyror i menaxhuar”, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Rezervati natyror i menaxhuar i liqenit të Shkodrës, kufizohet:

Nga veriu: Me pikën kufitare “Hani i Hotit” (42° 20’17” 19° 26’);

Nga perëndimi: Me kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë me Republikën Serbi-Mali i Zi;

Nga lindja: Me rrugën kombëtare automobilistike Shkodër-Hani i Hotit;

Nga jugu: Me vijën që bashkon grykëderdhjen e liqenit të Shkodrës me pikën kufitare (koordinatat: 42° 04’18” 19° 23’, 42° 03’08” 19° 29’30”).

3. Rezervati natyror i menaxhuar i liqenit të Shkodrës ka një sipërfaqe të përgjithshme 26 535 ha, të përbërë nga:

- sipërfaqe ujore 15 719 ha;

- sipërfaqe pyjore e shkurre 1965 ha;

- të tjera 8851 ha.

4. Rezervati natyror i menaxhuar i liqenit të Shkodrës ndahet në zonat, si më poshtë vijojnë:

a) Zonë qendrore (në hartë e shënuar me “1/a”) e përbërë nga:

Bregu i liqenit nga ekstremi perëndimor i fshatit Zogaj deri në kufirin e Republikës së Shqipërisë me Malin e Zi dhe shpati i malit të Taraboshit nga kuota 494 m lartësi, në jug, deri 20 m në brendësi të ujërave të liqenit, në veri, brenda segmentit Zogaj-kufiri shqiptaro-malazez. Në këtë zonë të zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes.

b) Zonë e menaxhimit të habitateve (në hartë e shënuar me “2/a”) e përbërë nga:

e gjithë sipërfaqja ujore e liqenit, me përjashtim të asaj të përfshirë në zonën “1/a”, përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike; bregu perëndimor i pjesës shqiptare nga ura e Bunës, në lindje, deri në fshatin Zogaj, në perëndim (kufiri me zonën “1/a”, të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike), duke përfshirë të gjithë gjerësinë e këtij segmenti, deri në lartësinë 300 m në faqen e malit të Taraboshit, në jug.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes.

c) Zona e zhvillimit tradicional (në hartë e shënuar “3”) e përbërë nga:

e gjithë sipërfaqja në pjesën lindore të liqenit, e kufizuar, në perëndim, me zonën 2/a, të përmendur në shkronjën “b” të kësaj pike, deri në rrugën automobilistike Shkodër-Hani i Hotit, në lindje, dhe qytetin e Shkodrës, në skajin juglindor.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.


5. Administrata e rezervatit natyror të menaxhuar të liqenit të Shkodrës përbëhet nga dhjetë punonjës (rangers), që janë në përbërje të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Për vitin 2006 këta punonjës do të paguhen nga projekti italian i peshkimit “Programi i mbështetjes së peshkimit artizanale dhe i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Shkodrës: (COD MAE: 6661/COOP/ALB) dhe pas këtij viti, nga Buxheti i Shtetit.

6. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që, në bashkëpunim me pushtetin vendor, organizatat jofitimprurëse, përfaqësuesit e komunitetit dhe institucionet shkencore, të hartojë rregulloren e administrimit, planin e menaxhimit dhe programin e monitorimit të rezervatit natyror të menaxhuar të liqenit të Shkodrës.

7. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.693, datë 10.11.2005

PËR SHPALLJEN E KOMPLEKSIT LIGATOR TË BUTRINTIT “PARK KOMBËTAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 pika 1 shkronja “b”, 6 e 13 pika 1 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Park Kombëtar” të territorit natyror të kompleksit ligator të Butrintit, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kufijtë e Parkut Kombëtar të Butrintit janë:

Në veri: Vija lidhëse Bredenesh-Kallmit-Qenuri, që kalon në tokat bujqësore të Vurgut;

Në lindje: Vija lidhëse Qenuri-Xarrë, duke kaluar nëpër kurrizin e malit të Miles;

Në përëndim: Vija lidhëse nga Bredeneshi deri në kufirin shtetëror me Republikën e Greqisë, përfshi ishujt e Ksamilit;

Në jug: Vija lidhëse Xarrë-Shëndelli-Vrrinë, deri në Stillo.

3. Parku Kombëtar i Butrintit përfshin një sipërfaqe prej 8591.2 ha, ku ndodhen:

- Sipërfaqe ujore (lagunë, det dhe ligatina të përkohshme)	2 509	ha;
- Makie, me mbizotërim të ilqes	4 272	ha;
- Pisha	39	ha;
- Shkëmbinj të zhveshur	208	ha;
- Ishuj	6.2	ha;
- Pemë frutore	202	ha;
- Sipërfaqe të banuara dhe tokë bujqësore	1 355	ha.

4. Parku Kombëtar i Butrintit ndahet në zonat, si më poshtë vijojnë:

a) Zona qendrore të ruajtjes së biodiversitetit, të shënuara në hartë me shkronjën “A”, me sipërfaqe 3980 ha, që përcaktohen si zona me vlera të mëdha për natyrën dhe biodiversitetin. Në këtë zonë të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

b) Zona rikrijimi, të shënuara në hartë me shkronjën “B”, me sipërfaqe 592 ha, që përcaktohen si zona ku mund të zhvillohen një sërë veprimtarish me karakter edukimi, rikrijimi, si dhe veprimtari të tjera lehtësuese, që nuk cenojnë funksionet e Parkut Kombëtar dhe vlerat ekologjike, kulturore dhe natyrore të tij. Në këtë zonë të zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes.

c) Zona të përdorimit tradicional, të shënuara në hartë me shkronjën “C”, me sipërfaqe 3 081.2 ha që përcaktohen si zona me burime natyrore, ku kryhen veprimtari tradicionale, ekonomike dhe të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Në këtë zonë të zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes.

ç) Zona të përdorimit të qëndrueshëm, të shënuara në hartë me shkronjën “D”, me sipërfaqe 938 ha, ku mundësohet zhvillimi i veprimtarive të reja, të qëndrueshme, zona të cilat kanë edhe funksione të një zone buferike për zonat urbane fqinje dhe veprimtaritë ekonomike intensive.


5. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me organet e pushtetit vendor, me organizatat jofitimprurëse dhe me përfaqësues të komunitetit, të hartojë planin e menaxhimit të zonës.

6. Ngarkohet zyra e administrimit dhe e koordinimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, si komitet i menaxhimit të zonës, që në bashkëpunim me institucionet e specializuara, të realizojë menaxhimin e zonës dhe të kontrollojë zbatimin e planit menaxhues.

7. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.694, datë 10.11.2005

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS, NË LAGJEN
GRANICË, NË BASHKINË E GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private të z.Pandeli (Pano) Kalanderi, që preken nga rikonstruksioni i rrugës në lagjen Granicë, në qytetin e Gjirokastrës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Gjirokastrës.
3. Pronari i këtyre pasurive të paluajtshme, të kompensohet në vlerë të plotë prej 554 099 (pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, për sipërfaqen 26 m² (truall), me çmim 750 lekë/m², me vlerë të përgjithshme prej 19 500 (nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh dhe për sipërfaqen 30 m² (garazh) të vlerësuar në shumën prej 534 599 (pesëqind e tridhjetë e katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh.
4. Fondi prej 554 099 (pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga bashkia e Gjirokastrës.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 116 000 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë, të përballohet po nga bashkia e Gjirokastrës.

6. Punimet të përfundojnë brenda muajit dhjetor 2005.
7. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit nëntor 2005.
8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe bashkia e Gjirokastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS NË LAGJEN GRANICË, NË BASHKINË GJIROKASTËR

Për tokën truall

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/toke truall	Çmimi i tokës/m ² (lekë)	Vlera në (lekë)
1.	Pandeli (Pano) Kalanderi	26 m ²	750	19 500

Për garazhin

Nr.	Emri, mbiemri	Emërtimi garazh	Vlera në (lekë)
1.	Pandeli (Pano) Kalanderi	30 m ²	534 599

Gjithsej vlera totale e shpronësimit: 554 099 lekë.

VENDIM **Nr.695, datë 10.11.2005**

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (TOKË ARË), QË PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË QYTETIN E ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë arë), të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i varrezave publike në qytetin e Elbasanit.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Elbasanit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 7182 m² tokë arë, të vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 13 825 350 (trembëdhjetë milionë e tetëqind e njëzet e pesë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekësh.
4. Ky fond të përballohet nga bashkia e Elbasanit.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale në shumën 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet po nga bashkia e Elbasanit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit nëntor 2005.
7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe bashkia e Elbasanit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE
PUBLIKE NË QYTETIN E ELBASANIT

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/toke arë	Çmimi tokës/m ²	Vlera në total (lekë)
	Trashëgimtarët e familjes Haxholli	2502 m ²	1 925 lek	4 816 350
	Sanije Zenelhxha (Hoxholli) Dallëndyshe Ahmet Palloshi Fatos Ahmet Zenelhxha Dituri Ahmet Zenelhxha Robert Ahmet Zenelhxha Sulejman Latifi Luljeta Latifi Xhaferr Zenelhxha (Hoxholli) Ymer Zenelhxha Adriatik Zenelhxha Myzejen Pasmaqi Atlantik Zenelhxha Dashuni Harrja Fisnik Zenelhxha Pupulina Gjevori Drita Ballco Qemal Zenelhxha Sali Zenelhxha Leonard Zenelhxha Durim Zenelhxha Xhemile Gora Fatmira Veizi (Cankja) Mit'hat Veizi Bashkëpronarët e familjes Vyshka Nashifer Ymer Meti Sabaudin Ymer Vyshka Gjinovefa Ymer Shuteriqi Fatush Ymer Vyshka Lavdiye Ymer Dimashi	4680 m ²	1925 lekë	9 009 000

Gjithsej vlera totale e shpronësimit: 13 825 350 lekë.

VENDIM
Nr.702, datë 10.11.2005

**PËR PËRZGJEDHJEN E ORGANIZATAVE TË PUNËDHËNËSVE DHE TË SINDIKATAVE
MË TË PËRFAQËSUARA NË KËSHILLIN ADMINISTRATIV TË INSTITUTIT TË
SIGURIMEVE SHOQËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave “b” e “c” të pikës 1 të nenit 72 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat më të përfaqësuar, që do të përzgjidhen për në këshillin administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, janë si më poshtë vijon:

A)

- Konfederata e Organizatave të Punëdhënësve (KOP);
- Bashkimi i Organizatave të Biznesit Shqiptar (BOBSH);
- Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë.

B)

- Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);
- Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);
- Unioni i Sindikatave të Punonjësve të Shqipërisë (USPSH).

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.707, datë 16.11.2005

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
110/20 KV, BURDULLIAS, BERAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV, Burdullias, Berat, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH sh.a., Tiranë.

3. Pronari i pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, znj.Selime Fero Qalliu, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 3405 m² tokë bujqësore, ullishte, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 1 021 500 (një milion e njëzet e një mijë e pesëqind) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e KESH sh.a., zëri “Kosto vendore për shpronësimet”.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën 86 000 (tetëdhjetë e gjashtë mijë) lekë të përballohet nga KESH, sh.a., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit nëntor 2005 dhe të përfundojë brenda këtij viti.

7. Punimet për ndërtimin e këtij nënstacioni të përfundojnë brenda muajit maj 2006.

8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe KESH sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT
110/20 KV BURDULLIAS, BERAT

Rrethi: Berat
Qyteti: Berat (Barrikadë)

LLOJI I PASURISË SË PALUAJTSHME QË SHPRONËSOHET: TOKË BUJQËSORE ULLISHTË

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sasia në m ²	Çmimi në lekë/m ²	Vlera e kompensimit në lekë	Adresa
1.	Selime	Fero	Qalliu	Tokë bujqësore ullishtë	8501	4/153	3405	300	1 021 500	Burdullias, Berat (Barrikadë)
	Totali								1 021 500	

Sqarime. Shpenzime procedurale: Publikime 86 000 (tetëdhjetë e gjashtëmijë) lekë.

Vlera totale e shpronësimit = 1 021 500 + 86 000=1 107 500 (një milion e njëqind e shtatë mijë e pesëqind) lekë.

URDHËR
Nr.6, datë 25.11.2005

PËR SEKUESTRIMIN E ASETEVE TË SHTETASIT JORDANEZ ABDUL LATIF SALEH, I NJOHUR EDHE SI: A) ABDYL LATIF A.A. SALEH, B) ABDYL LATIF SALEH, C) DR. ABD AL-LATIF SALEH, D) ABDYL LATIF A.A. SALEH ABU HUSSEIN, E) ABD AL-LATIF SALIH, F) ABU AMIR

Në mbështetje të nenit 102 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ligjit nr.8865, datë 14.03.2002 për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Luftën Kundër Financimit të Terrorizmit e vitit 1999, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", shtuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.671, datë 26.10.2005 "Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit"',

URDHËROJ:

1. Të sekuestrohen menjëherë të gjitha llogaritë, investimet dhe asetet e shtetasit Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si:

a) Abdyl Latif A.A. Saleh, b) Abdyl Latif Saleh, c) Dr. Abd al-Latif Saleh, d) Abdyl Latif A.A. Saleh Abu Hussein, e) Abd al-Latif Salih, f) Abu Amir, me shtetësi jordanëze dhe shqiptare, i datëlindjes 05.03.1957, lindur në Bagdad, Irak, me banim të përkohshëm në Emiratet e Bashkuara Arabe.

2. Të ndalohet menjëherë dhënia e shërbimeve financiare, fondeve, mjeteve financiare ose aseteve të tjera përmes Shqipërisë për personin e lartpërmendur.

3. Të sekuestrohen menjëherë të gjitha llogaritë, çdo llogari që mbahet në emër të, prej, për llogari të, ose në përfitim të Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si:

a) Abdyl Latif A.A.Saleh, b) Abdyl Latif Saleh, c) Dr. Abd al-Latif Saleh, d) Abdyl Latif A.A. Saleh Abu Hussein, e) Abd al-Latif Salih, f) Abu Amir.

4. Të sekuestrohen të gjitha llogaritë e identifikuar, specifikuar dhe renditur më poshtë (sipas numrave të llogarive, bankave, emërimit të llogarisë) në emër të, prej, për llogari të, ose në përfitim të

e Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si:

a) Abdyl Latif A.A. Saleh, b) Abdyl Latif Saleh, c) Dr. Abd al-Latif Saleh, d) Abdyl Latif A.A. Saleh Abu Hussein, e) Abd al-Latif Salih, f) Abu Amir.

- Llogaritë bankare në Bankën Arabe Shqiptare Islamike (sot Banka e Bashkuar e Shqipërisë - UBA)

- Llogaritë bankare të biznesit në UBA, së bashku me Jasin Kadi, ku Abdul Latif Saleh ka 10 % të kapitalit si bashkëpronar.

Llogari bankare

Emërtimi i shoqërisë

100 098

“Medicare Pharmacy” sh.p.k.

100 099

“Medicare Co Ekspenses” sh.p.k.

100 104

“MediCare Co” sh.p.k.

100104-6

“MediCare Co” sh.p.k.

100459-2

“Medicare ltd (expenses)” sh.p.k.

100459 -9

“Medicare ltd (expenses)” sh.p.k.

100101-1

“Cavallo-Revenue” sh.p.k..

100102-3

“Cavallo-Revenue” sh.p.k.

100101-7

“Cavallo-Revenue” sh.p.k.

100164-7

“Loxhall” sh.p.k.

- Llogaritë bankare në UBA si fondacion: Fondacioni FLS - “Fountain of Life and Science”

Llogari bankare

Emërtimi i shoqërisë

100439

“Fountain of Life and Science” Center

100442

“Fountain of Life and Science” constr.

100438

“Fountain of Life and Science” school

100457

“Fountain of Life and Science” Tama

100458

“Fountain of Life and Science” Arthroscopy

100316

General “Fountain of Life and Science”

100352

“Fountain of Life and Science”

100317

“Fountain of life and science”

100037

“Fountain of life and science”

100038

“Fountain of life and science”

100323

“Fountain of life and science”

- Llogaritë bankare të Abdyl Latif Saleh në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë si individ:

000100-3 individ Abdyl Latif Saleh

000690-7 individ Abdyl Latif Saleh

000690-9 individ Abdyl Latif Saleh

- Llogaritë bankare të Abdyl Latif Saleh në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë individuale e përbashkët me përfaqësuesin e tij Hamza Abu Rayan:

201-01-40-01-000-134-8

- Llogaritë bankare të biznesit në Bankën Tregtare Ndërkombëtare (Malajziane):

(Të përfaqësuesit të tij, shtetasit arab Hamza Abu Rayan)

Llogari bankare

Shoqëria ose individ

000700/

“Loxhall” sh.p.k.

000428/ 2

“Loxhall” sh.p.k.

1/ 001/ 000700/ 0

Individ Saleh, Rayan

3/ 001/ 000428/ 2

Individ Saleh, Rayan

3/001/000710

Individ Saleh, Rayan

- Llogaritë bankare të biznesit në ABA-Bankën Amerikane të Shqipërisë, së bashku me Yassin Kadi, ku Abdul Latif Saleh ka 10 % të kapitalit si bashkëpronar dhe si administrator është Hamza Abu Rayan.

Llogari bankare

Shoqëria ose individ

200515

“Loxhall”

200203

“Loxhall”

413377

(Abdul Latif Saleh, Hamza Abu Rajan)

5. Të sekuestrohet menjëherë çdo lloj pasurie, e luajtshme ose e paluajtshme, mbajtur në emër, prej, për llogari, ose në përfitim të Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si: a) Abdyl Latif A.A. Saleh, b) Abdyl Latif Saleh, c) Dr. Abd al-Latif Saleh, d) Abdyl Latif A.A. Saleh Abu Hussein, e) Abd al-Latif Salih, f) Abu Amir.

6. Të sekuestrohet menjëherë çdo pasuri e luajtshme ose jo, zotërimi i tyre, ose llogaritë e mbajtura nga çdonjëri prej personave fizikë a juridikë të identifikuar më poshtë:

6.1 "Medicare" sh.p.k., "Medicare Imp & Exp", regjistruar me vendim gjykate nr.4716, datë 03.06.1994, Tiranë.

6.2 "Loxhall" sh.p.k., regjistruar me vendim gjykate nr.2922/1, datë 01.03.1999 (6240), datë 01.03.1999, ndryshuar emri i shoqërisë nga "Loks Holl" në "Cavallo" sh.p.k., regjistruar me vendim gjykate nr.2544, datë 22.03.1994, Tiranë.

6.3 Fondacioni "Fountain of Life and Science"-në shqip: "Burimi i Jetës dhe i Shkencës", regjistruar me vendim të gjykatës, Tiranë nr.70/1, datë 21.02.1995.

7. Të sekuestrohen pasuritë e paluajtshme, troje të mbajtura në emër, prej, për llogari, ose në përfitim të e Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si:

a) Abdyl Latif A.A. Saleh, b) Abdyl Latif Saleh, c) Dr. Abd al-Latif Saleh, d) Abdyl Latif A.A. Saleh Abu Hussein, e) Abd al-Latif Salih, f) Abu Amir,

të identifikuar më poshtë:

7.1 Truall 550 m² në zonën kadastrale (80 70), që kufizohet në lindje nga Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", në jug, pronë e qytetarit Besnik Shtino, në përfundim me familjen "Kotoni", në veri nga rruga. Trualli është në vendin e ndërtimit të dy kullave 15+2- katëshe në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit Tiranë", në të cilën Abdul Latif Saleh ka 250 m².

7.2 Kati nëntokë: (kuota 3.00-0.00) bashkëpronar me 2.5 %.

7.3 Kati përdhe i objektit (kuota+0.00 -+ 4.00), një ambient me sipërfaqe 22m², me fasadë lindore, i kufizuar nga veriu me ambientin e Besnik Shtinos dhe nga jugu me ambientin e shoqërisë Karavan.

7.4 Kati i katërt: (kuota +15.20 - +18.40) të katër apartamentet që ndodhen në kate: A1-94 m², A2 - 94.5 m², A3 - 94 m² dhe A4 - 94.5 m². Gjithsej, 377 m².

8. Të sekuestrohen dhe bllokohen pasuritë e paluajtshme ose të të ardhurave nga shitja e pasurive, të identifikuar nga hetimet paraprake të bëra nga prokuroria, si pronë e shtetasit jordanez Abdyl Latif Saleh.

9. Për shkak se mund të jenë kryer lëvizje të llogarive, të investimeve dhe të pasurive të ngrira ose të sekuestruara të subjektit dhe për arsye se mund të mos jenë identifikuar që të gjitha llogaritë, investimet, shoqëritë tregtare apo persona juridikë të tjerë, dhe pasuritë e tjera, kërkohet nga të gjitha institucionet në Shqipëri, degët ose filialet e tyre, vendase ose të huaja, që të kontrollojnë regjistrat e tyre dhe të identifikojnë, sekuestrojnë, bllokojnë dhe raportojnë llogaritë, investimet, kompanitë dhe pasuritë në emër të tij dhe/ose të subjektit duke filluar nga data 16.09.2005.

10. Të kryhet sekuestrimi ose bllokimi i llogarive, investimeve, shoqërive tregtare a personave juridikë të tjerë, dhe pasurive të tjera ekzistuese pavarësisht nga pronësia aktuale në rast se subjekti, nën ndonjërin nga emrat e identifikuar, ka qenë pronari i tyre duke filluar nga data 16.09.2005.

11. Të njoftohet menjëherë me shkrim Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave për llogaritë, investimet dhe pasuritë e tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre.

12. Të plotësohet raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD) për transaksionet që transferojnë pronësinë e llogarive, investimeve ose të pasurive të tjera të mbajtura nga subjekti duke filluar nga data 16.09.2005 dhe të dërgohet te Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave menjëherë dhe jo me vonë se 72 orë nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

13. Të ndalohet dhënia e shërbimeve financiare, mjeteve financiare ose pasurive të tjera subjektit ose ndonjë personi fizik ose juridik të dyshuar se financon ose ndihmon subjektin. Nëse vëreni, konstatoni një mbështetje ose ndihmë të kësaj natyre, duhet të përgatitni dhe të dorëzoni një raport të aktivitetit të dyshimtë te Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.

14. Të gjithë personat që kanë detyrime kontraktuale të lidhura përpara datës 16 shtator 2005

me shtetasin jordanез Abdul Latif Saleh, i njohur edhe si: a) Abdyl Latif A.A. Saleh, b) Abdyl Latif Saleh, c) Dr. Abd al-Latif Saleh, d) Abdyl Latif A.A. Saleh Abu Hussein, e) Abd al-Latif Salih, f) Abu Amir, me kompanitë ose investimet e tjera të tij, subjekt i këtij urdhri, depozitojnë në llogarinë e çelur pranë Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave.

15. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.07.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", si: Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Ministria e Rendit Publik, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, subjektet dhe autoritetet e tjera raportuese të ligjit nr.8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", të ndryshuar, si dhe Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

16. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr.24, datë 26.10.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 13.1.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.30/10 Akti, që i përket:

KËRKUESI: AGIM MUÇA, përfaqësuar nga avokat Fariz Xhurxhi, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: PROKURORI I PËRGJITHSHËM, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr.412, datë 23.6.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.

Kërkuesi pretendon se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është antikushtetues për këto arsye:

- Gjykimi i çështjes penale në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa praninë e avokatit të zgjedhur prej tij ose të ndonjë mbrojtësi tjetër. Rekursi i prokurorit nuk i është komunikuar drejtpërdrejt të pandehurit, sipas rregullave që parashikon Kodi i Procedurës Penale. Nga ky gjykim është rënduar në mënyrë të dukshme pozita e të gjykuarit, duke ia ndryshuar masën e dënimit me një dënim më të rëndë.

- Juridiksioni rishikues i Gjykatës së Lartë është kontrolli i respektimit të zbatimit të ligjit dhe nuk ka të bëjë me vlerësimin apo analizën e provave. Kolegji Penal e ka zgjidhur vetë çështjen duke bërë analizë të provave, ndërkohë që për rivlerësimin e fakteve dhe zbatimin e ligjit duhej të vendoste gjykata e apelit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Sadushi, përfaqësuesin e kërkuesit dhe shqyrtoi çështjen

në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi është gjykuar dhe dënuar me 8 (tetë) vjet burgim nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë për veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë, vepër e parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.547, datë 22.10.2003, ka prishur vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor dhe ka pushuar çështjen penale në ngarkim të tij.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ka lënë në fuqi vendimin nr.701, datë 10.7.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Çështja është gjykuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori. Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore nuk rezulton që rekursi i prokurorit t'i jetë komunikuar kërkuesit ose avokatit të tij, por vëllait të të pandehurit. Në këto kushte, Gjykata e Lartë e ka zhvilluar seancën gjyqësore vetëm në prani të prokurorit dhe i ka ndryshuar vendimet e gjykatave duke e përqesuar pozitën e kërkuesit me një dënim më të rëndë.

Pretendimin e vet për shkelje të së drejtës për t'u mbrojtur, kërkuesi synon ta argumentojë me faktin se zhvillimi i gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë është bërë pa praninë e mbrojtësit, gjë që, sipas tij, ka sjellë rëndimin e pozitës së të gjykuarit.

Problemi që shtrohet për zgjidhje përpara Gjykatës Kushtetuese qëndron në përcaktimin e ekzistencës ose jo të shkeljes të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kur pavarësisht nga respektimi ose jo i kërkesave procedurale për njoftimin, gjykimi i nisur me rekurs të prokurorit është zhvilluar në mungesë të avokatit të kërkuesit.

Raste të tilla analoge, madje me specifikat konkrete e të posaçme të tyre, gjenden të trajtuara në jurisprudencën kushtetuese, në vendimet përkatëse të të cilave Gjykata Kushtetuese ka argumentuar se ato përbëjnë çështje të juridiksionit kushtetues dhe, konkretisht, të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Meqenëse rasti në shqyrtim ka ngjashmëri me qëndrimin që Gjykata Kushtetuese ka mbajtur në një rast të mëparshëm, ajo e çmon si të domosdoshme referimin tek argumentet e parashtruara në atë vendim. Kështu, ndërmjet të tjerave, Gjykata Kushtetuese arsyeton: “... situata juridike, kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, nuk është e njëllajt me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Prania personale e të pandehurit në seancën gjyqësore për shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga mbrojtësi i tij nuk është e domosdoshme nëse objekt shqyrtimi janë trajtimet dhe përfundimet juridike të arritura nga gjykata më e ulët, vendimi i së cilës nuk mund të ndryshohet në disfavor të të pandehurit. Në këto raste, Gjykata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të avokatit të palës së akuzuar, për shkak se argumentet ligjore ai i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj.

Ndryshe paraqitet situata kur, si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart në potencë mundësinë e përqesimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi të zhvillohej pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij. Gjykata e Lartë, kur ka gjykuar këtë rast konkret, me përjashtim të argumenteve të paraqitura nga prokurori, nuk ka pasur të administruar asnjë argument ligjor nga pala e akuzuar. Çështja vështirësohet edhe për arsye se me paraqitjen e rekursit nga prokurori, Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon mundësinë e paraqitjes së kundërrekursit nga pala kundërshtare. Pjesëmarrja e të gjykuarit dhe në mënyrë të veçantë e avokatit të tij, kërkohet për të siguruar jo vetëm të drejtën për t'u mbrojtur, por edhe respektimin e parimit të barazisë së armëve në një proces ligjor.”¹

Çështja që i përket kërkuesit Agim Muça është shqyrtuar në Gjykatën e Lartë mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, në të cilin ky ka kërkuar rëndimin e pozitës së të pandehurit. Gjykata Kushtetuese çmon se, përderisa avokati i të pandehurit nuk ka qenë i pranishëm në gjykim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej ta zhvillonte gjykimin pa shqyrtuar dhe administruar shkaqet e mosparaqitjes së tij dhe pa i dhënë mundësi palës së akuzuar për të realizuar mbrojtjen ligjore. Prandaj në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, dilte e domosdoshme për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë krijimi i kushteve dhe marrja e masave të nevojshme që seanca

¹ Vendimi nr.23, datë 13.10.2005 i Gjykatës Kushtetuese.

gjyqësore të zhvillohej në prani të avokatit. Dispozitat e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe ato të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut formulojnë mbrojtjen e interesave të të pandehurit në një proces, sepse ky i fundit është personi që do të prekej drejtpërdrejt nga pasojat e një procesi të zhvilluar pa pjesëmarrjen e avokatit.

Mbi bazën e këtyre argumenteve, Gjykata Kushtetuese konkludon se gjykimi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka cenuar të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Kushtetuese nuk e çmon të arsyeshme të shqyrtojë pretendimin tjetër të kërkuesit për qëndrimin e mbajtur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për mënyrën e vlerësimit të provave, për shkak se kërkuesi e ka përdorur këtë pretendim në funksion të argumenteve që kanë të bëjnë me cenimin e procesit ligjor, të cilat Gjykata Kushtetuese i pranon gjatë rrjedhës arsyetuese të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “f”, 134 pika 1 shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.412, datë 23.6.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.25, datë 28.10.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtar e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 29.6.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.35 Akti, që i përket:

KËRKUESI: SHOQËRIA “EPSEM GRAND”, përfaqësuar nga Olion Kaso, me autorizim.

SUBJEKTI I INTERESUAR: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit Abaz Deda, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr.1446, datë 13.7.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për papajtueshmërinë me Kushtetutën të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë:

- Gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa dijeninë e tij, pa u planifikuar e pa u shpallur më parë data për zhvillimin e seancës gjyqësore, duke i mohuar të drejtën e mbrojtjes.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fehmi Abdiu, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.1865, datë 21.4.2004, në përfundim të gjykimit të kërkesës së kërkuesit me objekt detyrim për shumën 1 085 616 lekë, ka vendosur nxjerrjen e çështjes civile jashtë juridiksionit gjyqësor.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi ankimin e kërkuesit, me vendimin nr.1446, datë 13.7.2004, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kërkuesi, në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, sepse nuk është bërë lajmërimi për ditën e orën e gjykimit të çështjes, duke pretenduar se, në këtë mënyrë, gjykata ka zhvilluar një proces të parregullt.

Gjatë gjykimit, kërkuesi ka shtuar se edhe njoftimi i datës 29.6.2004, për gjykimin e çështjes në datën 13.7.2004, është në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe standardet kushtetuese, dhe i ka mohuar të drejtën për t'u mbrojtur.

Gjykata Kushtetuese konstaton se këto dy pretendime, edhe pse janë lidhur me një problem të vetëm, me të drejtën e mbrojtjes, duhen trajtuar veç nga njëri-tjetri.

Është vërtetuar se sekretaria e Gjykatës së Lartë në datën 9.6.2004 ka bërë shpalljet për çështjet që do të shqyrtonte Kolegji Civil në datën 13.7.2004 dhe në datën 29.6.2004 ka bërë një shpallje tjetër për po atë datë.

Gjykata Kushtetuese çmon se kjo ka të bëjë me metodën e punës së asaj zyre dhe nuk përbën shkelje në aspektin kushtetues. Fakti që, në shpalljet e bëra në datën 9.6.2004, për gjykimet që do të zhvilloheshin në datën 13.7.2004, nuk parashikohej çështja e kërkuesit (për të cilën e kishte paraqitur vetë rekursin për në Gjykatën e Lartë), nuk e përjashtonte atë nga detyrimi për të ndjekur të gjitha njoftimet që do të bëheshin pas asaj date, derisa të merrte dijeni për ditën e gjykimit. Kërkuesi detyrohej që të ndiqte në vazhdimësi shpalljet që bëheshin nga sekretaria e Gjykatës së Lartë dhe pas datës 9.6.2004, gjë që e bën të pabazuar pretendimin e tij se e drejta për t'u mbrojtur i është mohuar nga Gjykata e Lartë.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se, për realizimin e të drejtave themelore kushtetuese, shtetasit detyrohen të përmbushin detyrimet ligjore që kanë për të ndjekur fatin e ankimit apo të rekursit të ushtruar prej tyre në marrjen dijeni për ditën e shqyrtimit të tyre. Pra pretendimi që gjykimi i çështjes është bërë pa u bërë më parë lajmërimi përkatës, nuk qëndron.

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të çështjes është konstatuar se shpallja për gjykimin e çështjes në datën 13.7.2004, është bërë në datën 29.6.2004, pra 14 ditë më parë se dita e gjykimit. Sipas paragrafit të dytë të nenit 482/2 të Kodit të Procedurës Civile, "... sekretaria e Gjykatës së Lartë shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit". Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, në llogaritjen e afatit 15-ditor nuk duhet marrë parasysh data e shqyrtimit të çështjes. Këtë kërkesë Gjykata e Lartë nuk e ka zbatuar në mënyrë rigoroze, pasi duhej ta gjykonte çështjen së paku një ditë më pas.

Por Gjykata Kushtetuese çmon se shkelja e përmbajtjes së paragrafit të dytë të nenit 482/2 të Kodit të Procedurës Civile, në kushtet dhe rrethanat e kryera, nuk e bën në thelb procesin gjyqësor të parregullt, në aspektin kushtetues. Shkaqet e parashtruara nga kërkuesi nuk pajtohen me konceptin që kanë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe praktika e Gjykatës Kushtetuese për procesin e rregullt ligjor. Gjatë procesit gjyqësor që zhvillohet në të gjitha shkallët e gjykimit, mund të konstatohen shkelje të ndryshme, por e rëndësishme është se jo çdo shkelje e ligjit mund të cenojë procesin e rregullt ligjor në aspektin kushtetues. Kjo Gjykatë në

praktikën e saj për këtë problem ka pohuar se: “ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo të drejtë tjetër të njohur me Kushtetutë dhe me ligj”,¹ dhe se: “Jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese për të investuar Gjykatën Kushtetuese për zgjidhjen e tyre sa herë shfaqet prezenca e shkeljes së normave procedurale”.²

Sa më lart, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e kërkuarit duhet të rrëzohet si e pabazuar në aspektin kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.26, datë 2.11.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergji Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtar e “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 11.4.2005 dhe 21.4.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.33 Akti, që i përket:

KËRKUESI: SHOQATA E QIRAMARRËSVE NË SHTËPITË SHTETËRORE, ISH-PRONË PRIVATE, përfaqësuar nga zoti Piro Polo dhe avokate Luljeta Petani, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Viktor Gumi, me autorizim.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

3. SHOQATA KOMBËTARE E TË SHPRONËSUARVE “PRONËSI ME DREJTËSI”, përfaqësuar nga avokat Agim Tartari, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe

¹ Vendimi nr.7, datë 28.2.2000 i Gjykatës Kushtetuese.

² Vendimi nr.222, datë 6.6.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

kompensimin e pronës”, si antikushtetues.

Kërkuesit kanë paraqitur këto shkaqe:

- Neni 9 i ligjit të lartpërmendur i diskriminon qiramarrësit në raport me pjesën tjetër të shoqërisë.

- Shteti nëpërmjet rregullimeve të ndryshme ligjore ka krijuar diferencime edhe midis vetë qiramarrësve.

- Neni 9, padrejtësisht, vë afate kohore të shkurtra për lirin e banesave, duke krijuar artificialisht pamundësi për Buxhetin e Shtetit për ndërtimin e apartamenteve të nevojshme.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me kthimin të pronarët e ligjshëm të pronave të tyre të marra arbitrarisht, qysh nga dalja e dispozitave përkatëse të vitit 1993, lindi nevoja e sistemimit dhe trajtimit të qiramarrësve të shtëpive shtetërore që do t’u ktheheshin pronarëve.

Nga viti 1993 e deri më tani, për rregullimin e këtij problemi sa ekonomik e juridik, po aq dhe social, kanë dalë një sërë dispozitash, e veçanërisht me rëndësi për çështjen është ligji nr.8030, datë 15.11.1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr.8647, datë 24.7.2000. Ky rregullim ligjor ka vazhduar deri në gusht 2004, kohë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji nr.9188, datë 1.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, neni 9 i të cilit kontestohet nga kërkuesit.

Në këtë dispozitë parashikohet:

“1. Banesat, pronë e subjekteve të shpronësuara, lirohen nga qiramarrësi brenda një afati 3-vjeçar. Qiramarrësit vazhdojnë të paguajnë qira të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave deri në dy vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Këshilli i Ministrave ngarkohet të sigurojë strehimin e qiramarrësve që kanë statusin e të pastrehëve nëpërmjet banesave me qira të ulët, kredive me interes të ulët ose banesave me qira të kompensuar nga shteti;

2. Në rastet e banesave të ndërtuara në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, banorët e tyre kanë të drejtën e blerjes së truallit gjatë procesit të legalizimit, të përcaktuar me ligj të veçantë. Vlerësimi i truallit bëhet sipas vlerës së tregut në momentin e kryerjes së legalizimeve të banesave.”

Nga analiza e dispozitave të mësipërme, të ballafaquara me parimet dhe normat kushtetuese, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se pika 1 e nenit 9 të ligjit nr.9188, datë 1.7.2004 duhet të shfuqizohet si antikushtetuese.

Deri në miratimin e hyrjen në fuqi të kësaj dispozite, qiramarrësit e shtëpive shtetërore ish-pronë private, kishin një sërë të drejtash, nga ku, në rrjedhën e disa viteve, një pjesë prej tyre përfituan. Ndër më kryesoret e këtyre të drejtave ishin: deri në zgjidhjen e strehimit, qiraja do të ishte sipas tarifave të vitit 1993 (neni 4 i ligjit nr.8647, datë 24.7.2000); shteti u siguronte banesë nga Enti Kombëtar i Banesave sipas kriterëve të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 (neni 1 i ligjit të lartpërmendur). Siç shihet sipas këtyre dispozitave, shteti mernte përsipër t’u siguronte banesë kundrejt privatizimit sipas kriterëve që shërbyen për privatizimin e banesave në vitin 1992 dhe së dyti deri në zgjidhjen e problemit qiraja nuk do të ndryshonte.

Ligji i ri nr.9235, datë 29.7.2004, në pikën 1 të nenit 9, bën ndryshime esenciale të të drejtat e qiramarrësve. Kështu ndërsa me dispozitat e mëparshme shteti mernte përsipër të zgjidhte strehimin duke i bërë kërkuesit pronarë mbi të njëjtat kriterë që përfitoi pjesa tjetër e popullit, dispozita e kontestuar nuk parashikon shprehimisht këto detyrime të shtetit. Dispozita parashikon sigurimin e strehimit të tyre nëpërmjet banesave me qira të ulët, kredive me interesa të ulëta ose banesave me qira të kompensuara nga shteti.

Veç kësaj, në dallim nga dispozita e mëparshme që “ngrinte” qiranë e banesave deri në zgjidhjen përfundimtare të strehimit të qiramarrësve (neni 10 i ligjit nr.8030, datë 15.11.1995), dispozita që kontestohet parashikon shprehimisht pagimin e kësaj qiraje “të ngrirë” deri në dy vjet nga hyrja e ligjit në fuqi, duke nënkuptuar që pas këtij afati qiraja liberalizohet.

Në ligjin e ri parashikohen edhe masa të tjera të cilat keqësojnë në një shkallë të ndjeshme pozitën e qiramarrësve. Kështu ndërsa në ligjin e mëparshëm (të shfuqizuar) si afat kohor për lirim të banesave merrej shprehimisht koha kur do të zgjidhej përfundimisht strehimi i qiramarrësve, në dispozitën e kontestuar, në mënyrë arbitrare e pa asnjë garanci të shprehur, parashikohet që qiramarrësit të lirojnë banesat brenda një afati 3-vjeçar.

Nga paraqitja e mësipërme del qartë që pika 1 e nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 cenon ndjeshëm një sërë të drejtash që kërkuesit kishin siguruar nëpërmjet legjislacionit, i cili ka pasur në përmbajtjen e tij edhe rekomandime që dilnin nga vendime të Gjykatës Kushtetuese.¹ Për më tepër, këto të drejta u realizuan për një pjesë të qiramarrësve duke ngelur pa u realizuar për një numër të konsiderueshëm, të cilëve, ashtu siç u parashtrua më lart, iu imponohen zgjidhje të reja, haptazi të pafavorshme e cilësisht të dallueshme nga ato të mëparshmet.

Gjykata Kushtetuese konstaton se në pikën 1 të nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, ka shkelje me karakter konceptual, të cilat cenojnë parimin e sigurisë juridike si pjesë përbërëse dhe e rëndësishme e shtetit të së drejtës, garantuar nga nenet 15, 17 e 18 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Doktrina e së drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Kjo siguri presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. “Nuk do të kishim të bënim me një rast të garantimit të besueshmërisë në sistemin e normave juridike nëse siguria lidhur me një situatë të caktuar juridike nuk mund të justifikohet dhe nuk mund të mbrohet materialisht.”²

Duke afirmuar parimin e sigurisë juridike dhe të elementeve kryesore përbërëse të saj, Gjykata Kushtetuese vë në dukje se ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se, nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes natyreshëm do të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike.

Nga shqyrtimi i çështjes del se, në rastin e dhënë, ndryshimi i ligjit të favorshëm ndaj një grupi të caktuar të popullsisë, nuk justifikohet me ndonjë interes publik të qenësishëm. Është e vërtetë që dispozita e ndryshuar favorizon pronarët e banesave, por nga ana tjetër ajo diskriminon një grup tjetër (dhe pse të vogël në numër), duke ia cenuar të drejtën minimale për të jetuar, atë të pajisjes së një strehe. T’u mohosh të drejtën shtresës së qiramarrësve për t’u bërë pronarë, t’u ndërpresësh kontratën e qirasë pa i garantuar strehë tjetër, janë veprime që nuk mund të përliqen me interesin publik.

Parimi i sigurisë juridike nuk mund të eliminojë çdo pasojë negative që mund t’i vijë individit nga rregullimi i ri. Kjo për shkak se siguria juridike është e pandashme nga parimi i shtetit social. Por, në rastin në shqyrtim, fjala nuk është për pasojat çfarëdo, por për pasojat thelbësore, sepse dispozita e re realizon një ndryshim konceptual mbi raportet e shtetit me qiramarrësit e banesave pronë private, ndryshim që sjell pasojat shumë të rëndësishme. Me raportet e vendosura me dispozitat e mëparshme, shteti kishte obligimin e zgjidhjes së strehimit të kësaj shtrese duke i bërë pronarë (ashtu si pjesën më të madhe të shtetasve të tjerë), me dispozitën e re të kontestuar, ai (shteti) i turr tej mase këto obligime, duke marrë përsipër, kryesisht, vetëm sigurimin e strehimit.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se dispozita e re (pika 1 e nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”) nuk është rezultat i një interesi publik apo i kërkesave të shtetit social. Përderisa në rastin konkret, pa asnjë shkak të përliqur, është prekur parimi i sigurisë juridike, kjo dispozitë është antikushtetuese e duhet të shfuqizohet.

Meqenëse me shfuqizimin e kësaj dispozite krijohet boshllëk lidhur me trajtimin e qiramarrësve në shtëpitë e ish-pronarëve, bazuar në nenin 78 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i rekomandohet Këshilli i Ministrave e Kuvendi të Shqipërisë të marrin masa për të bërë plotësimet e nevojshme në ligj.

¹ Vendimi nr.5, viti 1997 i Gjykatës Kushtetuese.

² Klaus Itern, *Dus Staatsrecht des Bundes Republik Deutschland* Band I-834.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f e 134/g, si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.27, datë 4.11.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjolla Meçaj	Anëtare e “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 28.6.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.33 Akti, që i përket:

KËRKUESI: ZAMIRA SHARRA, përfaqësuar nga avokat Rustem Gjata, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. ELHAM SHARA.
2. DORA ÇELKUPA, NATASHA ALIAJ, MIMOZA DIAMANTI, PAQYZE ÇEÇI, YLLKA KOTORRI, përfaqësuar nga avokat Ilirian Deshalla.
3. ILIRIAN SHARA, në mungesë.
4. KLEONIQI PASKO, në mungesë.
5. PREFEKTURA VLOREË, në mungesë.
6. KOMISIONI I KTHIMIT DHE I KOMPENSIMIT TË PRONAVE VLOREË, në mungesë.
7. BASHKIA VLOREË, në mungesë.
8. AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT, DEGA VLOREË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr.1392, datë 15.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr.138, datë 21.3.2000 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr.278, datë 20.3.2001 të Kolegji Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.2, datë 28.1.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1 e 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Kërkuesja ka paraqitur këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme:

- Padia në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë është ngritur nga prokuroria e rrethit, e cila, në bazë të dispozitave ligjore të kohës, nuk legjitimohej.

- Edhe pse në rekurs kishte shkaqe ligjore, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) padrejtësisht nuk e kaloi çështjen për shqyrtim gjyqësor.
- Kolegjet e Bashkuara nuk kishin të drejtë të pushonin gjykimin e rekursit të parashtruar nga kërkuesja.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesin e kërkueses, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.66, datë 28.12.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, dega Vlorë, trashëgimtarëve të Nuri Sharrës (ku përfshihet edhe kërkuesja) u është njohur pronësia mbi një truall me sipërfaqe prej 10.500 m². Me cilësinë e pronares së truallit, kërkuesja ka paraqitur në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit dokumente sipas të cilave në sipërfaqen e truallit të njohur përfshihet edhe një parcelë prej 79.596 m², ku ndodhej farmacia nr.5, të cilën kërkuesja pretendonte ta blinte duke përfituar nga e drejta e parablerjes. Në datën 11.9.1997 kërkuesja lidh kontratë shitblerjeje me Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, dega Vlorë, dhe bëhet pronare e ndërtesës ku ndodhej farmacia nr.5.

Personat e interesuar (farmacistët) janë ankuar në Prokurorinë e Rrethit Vlorë kundër këtij privatizimi. Nga verifikimet, prokuroria ka arritur në përfundimin se trualli mbi të cilin është ngritur farmacia nr.5 nuk i përket trashëgimlënësit Nuri Sharra. Ky truall ka qenë publik dhe në të, qysh prej vitit 1926 e deri disa vjet pas çlirimit, ka kaluar traseja hekurudhore. Sipas prokurorisë, meqenëse farmacia nr.5 ndodhej jashtë dhe larg truallit të njohur kërkueses, kjo e fundit ka arritur të sigurojë një vendim të dytë të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, dega Vlorë, me të njëjtin numër e datë, në përmbajtjen e të cilit është shtuar se në këtë tokë është ndërtuar farmacia nr.5.

Ndodhur para të dhënave të tilla, të dala nga kontrolli, Prokuroria e Rrethit të Vlorës, si paditëse, edhe farmacistet Yllka Kotorri, etj., si persona të tretë, me interesa të drejtpërdrejta për çështjen, kanë ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku kanë kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.66, datë 28.12.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, dega Vlorë, si dhe shpalljen të pavlefshme të kontratës së shitjes (privatizimit) të datë 11.9.1997 midis Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, dega Vlorë dhe kërkueses.

Gjykata Kushtetuese, në vendimet gjyqësore të atakuara nga kërkuesja, nuk identifikoi ndonjë element të procesit të parregullt ligjor, që mund t'i bënte ato (vendimet) antikushtetuese.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese nuk e ka konsideruar kontrollin mbi respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si një procedurë thjesht formale. Përkundrazi, në ushtrimin e kësaj kompetence Gjykata ka pasur parasysh se, në bazë të nenit 42/1 të Kushtetutës, procesi i parregullt ligjor lidhet drejtpërdrejt me lirinë, pronën dhe të drejta të tjera të njohura me Kushtetutë dhe me ligj. Për pasojë, thjesht inicimi i një procesi gjyqësor për një mosmarrëveshje me karakter administrativo-civil nuk do të thotë se realisht preken të drejtat e interesat e të paditurit, në rastin tonë të kërkueses. Fakti që padia për shfuqizimin e vendimit nr.66, datë 28.12.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, dega Vlorë është bërë nga prokurori (i cili sipas kërkueses nuk e ka pasur në kompetencë), nuk prek, në konceptin kushtetues, të drejtën e kërkueses. Në rastin konkret, padia dhe vetë procesi kanë një element tjetër thelbësor, që e bën atë të rregullt në bazë të Kushtetutës. Kërkimet në padi janë mbështetur nga persona të tretë, të thirrur nga paditësi e të pranuar nga gjykata, farmacistet, të cilat kanë interesa të plota e reale në zgjidhjen e çështjes. Përfashtimi i kërkuesit nga pronësia mbi truallin ku është ngritur farmacia dhe shpallja e pavlefshme e kontratës së shitjes së farmacisë në favor të kërkuesit, është kusht thelbësor për privatizimin e këtij objekti në favor të punonjësve që punojnë në të. Për pasojë, farmacistët, në kuptim të nenit 27/a të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, legjitimoheshin të ngrinin padi ndaj vendimeve të komisioneve.

Gjykata Kushtetuese konstaton gjithashtu se të dyja shkaqet e tjera të parashtruara nga kërkesja nuk paraqesin bindshëm elemente të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues dhe sipas praktikës së gjerë të kësaj Gjykate. Në mjaft vendime ajo është shprehur se në ushtrimin e kontrollit kushtetues nuk hyn në çmimin subjektiv që i bëjnë çështjeve Kolegjet e Gjykatës së Lartë, lidhur me kalimin e tyre në gjyq, e as nuk merr në këto raste rolin e arbitrit në raportet qytetar-Gjykatë e Lartë.

Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese ka pranuar në praktikën e saj se jo çdo shkelje me karakter procedural përbën proces të parregullt, objekt të kontrollit kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 42/1 e 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.28, datë 9.11.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i“ “
Kristofor Peci	Anëtar i“ “
Kujtim Puto	Anëtar i“ “
Vjollca Meçaj	Anëtar i“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i“ “
Petrit Plloçi	Anëtar i“ “
Sokol Sadushi	Anëtar i“ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 13.6.2005 dhe 14.7.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.31 Akti, që i përket:

KËRKUESI: HALIL KOKONOZI, përfaqësuar nga avokat Ilir Selenica, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. HAMIT DURO, përfaqësuar nga avokat Mirash Martini, me prokurë.
2. KASËM, SHKËLQIM dhe HYSEN MOLLA, përfaqësuar nga avokat Merko Muhametaj, me deklaram.
3. BASHKIA TIRANË, përfaqësuar nga Flora Kalaja, me autorizim.
4. ADMINISTRATORËT E SHOQËRISË NË ADMINISTRIM “VEFA” SHPK, përfaqësuar nga Kirov Babliku, me autorizim.
5. ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr.3345, datë 16.7.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.6, datë 13.1.2004 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1507, datë 15.7.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.

Kërkuesi pretendon se gjykatat i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këto

drejtime kryesore:

- Gjykata e rrethit gjyqësor, në kundërshtim me nenin 35 të Kodit të Procedurës Civile, ka gjykuar me një gjyqtar të vetëm padinë dhe kundërpadinë, vlera e të cilave kalon kufirin ligjor prej 10 000 000 lekë.

- Në gjykatën e rrethit gjyqësor, gjykimi është zhvilluar në mungesë të subjekteve të interesuara, sepse gjykata, në kundërshtim me nenin 79 të Kodit të Procedurës Civile, nuk ka urdhëruar njoftimin e akteve Avokatit të Shtetit për përfaqësimin në gjykim.

- Këto shkelje, megjithëse i janë parashtruar gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë, ato në kundërshtim me ligjin nuk i kanë vlerësuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuarit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen me objekt padie “anulim të vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave Tiranë” dhe me objekt të kundërpadisë “konstatimin absolutisht të pavlefshëm të kontratave të shitjes së një trualli”, ka vendosur pranimin e padisë së paditësit Hamit Duro dhe rrëzimin e kundërpadisë së kërkuarit Halil Kokonozi. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.6, datë 13.1.2004, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Pretendimet e kërkuarit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor lidhen me përbërjen e trupit gjykues, si dhe me rregullat e njoftimit për Avokaturën e Shtetit.

Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme të theksojë se pretendimet që janë paraqitur nga ankuesi i vlerëson në aspektin e kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor dhe të ndikimit të drejtpërdrejtë që ato mund të kenë sjellë në cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimi i kërkuarit për tejkalim të kufirit ligjor prej 10 milionë lekësh të vlerës së padisë nëpërmjet bashkimit të saj me vlerën e kundërpadisë, arsye kjo që sipas tij detyronte shqyrtimin e kësaj çështjeje nga një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, nuk është i drejtë nga pikëpamja kushtetuese.

Nga dosja gjyqësore rezulton se gjykata e rrethit gjyqësor dhe në veçanti gjykata e apelit e kanë shqyrtuar këtë pretendim të kërkuarit dhe ia kanë refuzuar si të pabazuar. Përcaktimi me saktësi nëse vlera e padisë dhe e kundërpadisë e kalojnë ose jo kufirin prej 10 milionë lekësh që parashikon neni 35 i Kodit të Procedurës Civile, në rastin konkret, është një çështje të provuari që nuk mund të rivlerësohet nga Gjykata Kushtetuese. Të dyja gjykatat në vendimet e tyre e kanë analizuar këtë pretendim të kërkuarit duke i dhënë përgjigje se vlera e padisë dhe e kundërpadisë nuk e kalon kufirin ligjor të përcaktuar me ligj.

Në këto kushte, bërja e një analize apo vlerësimi të ri nga ana e Gjykatës Kushtetuese të një prove të administruar në dosjen gjyqësore, që në rastin konkret lidhet me aktekspertimin e vlerës së objektit të padisë dhe të kundërpadisë, do ta deformonte procesin kushtetues dhe do ta shndërronte atë në një proces gjykimi të zakonshëm. Mbi këtë analizë, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkuari nuk provon se procesi gjyqësor ka qenë i parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

Edhe pretendimi tjetër i kërkuarit, që lidhet me antikushtetutshmërinë e procesit, për shkak të mosthirrjes dhe të mospjesëmarrjes në gjykimin në gjykatën e rrethit gjyqësor të Avokaturës së Shtetit, nuk është i drejtë.

Rezulton nga dosja gjyqësore që Avokatura e Shtetit nuk ka qenë e pranishme në gjykimin në gjykatën e rrethit gjyqësor, ndërkohë që në gjykatën e apelit ajo ka marrë pjesë. Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky pretendim duhet analizuar në aspektin e lidhjes së drejtpërdrejtë që ka ekzistenca e një shkeljeje ligjore me vetë kërkuarin, si dhe të ndikimit që kjo shkelje mund të ketë sjellë mbi ecurinë e procesit gjyqësor.

Pretendimi i kërkuarit për parregullsinë e procesit gjyqësor, për shkak të mungesës në këtë

gjykim të Avokaturës së Shtetit si përfaqësuese e palës së paditur, nuk lidhet me elementet thelbësore që kërkon e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Kuptimi i kësaj të drejte është analizuar gjerësisht në shumë vendime të Gjykatës Kushtetuese, si dhe të jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Zhvillimi i gjykimit në mungesë të palës është konsideruar shkelje e standardeve, kur si rrjedhojë e një shkeljeje të tillë, ankuesit i është cenuar një nga të drejtat kryesore që parashikon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe, në mënyrë të veçantë, e drejta për t'u dëgjuar dhe e drejta për t'u mbrojtur.

Mosprania në gjykimin në gjykatën e rrethit gjyqësor e Avokaturës së Shtetit, si dhe zhvillimi i gjykimit në mungesë të këtij organi, nuk përbëjnë për kërkuesin një pretendim kushtetues në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për arsye se ai i ka pasur të gjitha mundësitë të ushtrisë të drejtat e tij në këtë gjykim.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja "f" dhe 134 pika 1 shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.29, datë 9.11.2005

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 30.6.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.34 Akti, që i përket:

KËRKUESI: GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga këshilltari juridik, Idar Bistri, me autorizim.
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga drejtori i kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, me autorizim.

3. KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, në mungesë.

4. VLADIMIR SKËNDERI, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i nenit 34/1 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 "Për organizimin dhe

funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit të çështjes me objekt “anulim të vendimit nr.162, datë 14.9.2004 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, kanë pezulluar gjykimin dhe i kanë kërkuar Gjykatës Kushtetuese shfuqizimin e nenit 34/1 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, me argumentet e mëposhtme:

- Neni 34/1 i ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, në kundërshtim me nenin 147 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, u njeh gjyqtarëve të drejtën e ankimit për të gjitha masat disiplinore.

- Sipas nenit 147/6 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, Gjykata e Lartë nuk ka juridiksion për gjykimin e ankesave ndaj masave të tjera disiplinore të gjyqtarëve, me përjashtim të masës së shkarkimit nga detyra.

- Kur ekziston një përplasje e tillë midis normës ligjore dhe asaj kushtetuese, përparësinë e merr norma kushtetuese.

Përfaqësuesit e Kuvendit dhe të Këshillit të Ministrave arsyetuan trajtimin e kësaj çështjeje në dy drejtime kryesore:

- Aspekti i parë lidhet me të drejtën substanciale të gjyqtarit për t’u ankuar ndaj çdo vendimi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ligji që i njeh gjyqtarit të drejtën e ankimit për çdo masë disiplinore, nuk mund të bëhet antikushtetues, për shkak se ai tejkalon në mënyrë pozitive standardin kushtetues. Kushtetuta, në nenin 17/2 të saj, kujdeset për moskufizimin e standardeve dhe jo për tejkalimin pozitiv të tyre. Një zgjidhje e tillë përbën një garanci më shumë për pavarësinë e gjyqësorit.

- Aspekti i dytë ka të bëjë me të drejtën procedurale të gjyqtarit për t’u ankuar për vërejtjen e dhënë. E drejta e gjyqtarit për t’u ankuar në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për raste të tilla, nuk mund të merret e shkëputur nga e drejta e tij e ankimit për shkarkimin nga detyra. E drejta për t’u ankuar për masat e tjera disiplinore nuk konsiderohet zgjerim i juridiksionit gjyqësor të Gjykatës së Lartë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr.162, datë 14.9.2004, ka dhënë masë disiplinore “Vërejtje” ndaj subjektit të interesuar, Vladimir Skënderi, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Gjyqtari është ankuar ndaj kësaj mase disiplinore në Gjykatën e Lartë. Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, përfaqësuesi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë kërkoi mosshqyrtimin e çështjes me argumentin se Gjykata e Lartë nuk është kompetente për shqyrtimin e saj.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vlerësimin që i kanë bërë çështjes, kanë arritur në përfundimin se ekziston mospërputhje midis dispozitës ligjore dhe normës kushtetuese, dhe se zgjidhja përfundimtare e çështjes lidhet domosdoshmërisht me ligjin që kundërshtohet për antikushtetutshmëri. Në këto kushte, në bazë të nenit 145/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ato i kanë kërkuar Gjykatës Kushtetuese të shprehet për antikushtetutshmërinë e dispozitës objekt shqyrtimi.

Në nenin 34/1 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, parashikohet se ankimi ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit, *si dhe për çdo masë tjetër me karakter disiplinor* bëhet nga ky i fundit në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e këtij Këshilli. Sipas nenit 147 pika 6 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, kundër vendimit të shkarkimit nga detyra, gjyqtari ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë.

Për rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese çmon se merr rëndësi të veçantë analiza që i

duhet bërë hierarkisë së normave juridike. Kuptimi normativist bazohet në hierarkinë juridike dhe në supremacinë e normës kushtetuese ndaj akteve më të ulëta, që në doktrinën kushtetuese njihet si parimi i epërsisë (*supremacisë*) së Kushtetutës. Kushtetuta, si ligji themelor i shtetit, i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese, që përbën një parim tjetër të rëndësishëm, atë të kushtetutshmërisë funksionale.

Mbështetur në këto parime, veprimtaria dhe funksionet e të gjitha organeve shtetërore bazohen në Kushtetutë. Janë veprimtaria normëvënëse e organeve të autorizuar nga Kushtetuta, si edhe natyra e përmbajtja e ligjeve dhe e akteve nënligjore që ato nxjerrin, të cilat përcaktojnë edhe pozitën e këtyre akteve në hierarkinë e normave juridike. Nga kjo buron kërkesa dhe parimi, sipas të cilit aktet juridike më të ulëta duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material.

Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Ky është një parim themelor i sanksionuar në nenin 4 pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, sipas të cilit kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti. Përfshirja kushtetues, i parashikuar në këtë dispozitë, nënkupton se normat kushtetuese mund edhe të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti, kur Kushtetuta ka ngarkuar posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme dhe në përputhje me hierarkinë e normave.

Pra Kushtetuta përmban dispozita që rregullojnë zbatimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, duke i krijuar hapësirë ligjvënësit për të vepruar më shumë ose më pak, me përjashtim të rasteve kur vetë Kushtetuta parashikon ndryshe. Parë nga ky këndvështrim, është Kushtetuta që autorizon ligjvënësin që, duke respektuar konceptet dhe parimet kushtetuese, të caktojë kufijtë e hapësirës rregulluese nëpërmjet nxjerrjes së normave juridike.

Për t'i dhënë zgjidhje kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme se duhet të përqendrohet te mënyra e formulimit të nenit 147, pika 4 dhe 6, të Kushtetutës. Sipas pikës 4 të këtij neni: *“Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për transferimin e gjyqtarëve, si dhe për përgjegjësinë e tyre disiplinore sipas ligjit.”* Formulimi i kësaj dispozite përfshihet në ato raste përjashtimore kur normat kushtetuese nuk mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi në to është parashikuar mundësia e rregullimit të marrëdhënieve përkatëse me anë të ligjit. Kjo dispozitë e Kushtetutës përmban elementet e një norme referuese, për shkak se mënyrën e transferimit të gjyqtarëve dhe përgjegjësinë e tyre disiplinore ia ka deleguar ligjvënësit. Sipas dispozitës së sipërcituar, ligjvënësit i është dhënë e drejta që nëpërmjet ligjeve të rregullojë në mënyrë të hollësishme çështjet që përfshihen vetëm në këto dy drejtime të specifikuar.

Është i ndryshëm formulimi i nenit 147 pika 6, në të cilin rezulton se Kushtetuta nuk e ka autorizuar ligjvënësin, por ka marrë përsipër ta rregullojë vetë si çështjen e objektit të ankimit, ashtu edhe atë të organit kompetent që do të merret me shqyrtimin e tij. Në këtë mënyrë, kjo normë kushtetuese paraqitet si një dispozitë përjashtimore e kufizuese dhe si e tillë duhet interpretuar në mënyrë strikte. Kushtetuta, pa lënë shteg për mëdyshje, ka parashikuar se vetëm ankimi për masën e shkarkimit nga detyra të Këshillit të Lartë të Drejtësisë shqyrtohet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Mbështetur në kuptimin që del nga kjo analizë, Gjykata Kushtetuese çmon se neni 34 pika 1 e ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 *“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”*, që parashikon të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë ndaj çdo mase tjetër me karakter disiplinor, përbën tejkallim të përmbajtjes së dispozitës kushtetuese në dy drejtime, në aspektin e zgjerimit të masave të tjera disiplinore dhe në atë të tejkallimit të juridiksionit të Gjykatës së Lartë.

Standardi i pranuar nga Kushtetuta për mbrojtjen e statusit të gjyqtarit përqendrohet për t'u zbatuar ndaj masës së shkarkimit nga detyra të gjyqtarit dhe jo ndaj masave të tjera disiplinore. Masa e shkarkimit, si një masë e rëndë disiplinore, i jep fund karrierës së gjyqtarit dhe për rrjedhojë ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me statusin kushtetues të tij. Kushtetuta nuk ndalon ndërhyrjen në disiplinimin e gjyqtarëve për ato aspekte që lidhen me ushtrimin e funksionit të tyre. Janë këto arsye që shpjegojnë përse i është dhënë e drejta Këshillit të Lartë të Drejtësisë që, në bazë të ligjit, të procedojë gjyqtarët dhe të marrë ndaj tyre masa disiplinore. Lloji dhe natyra e masave disiplinore, si dhe procedura e marrjes së tyre janë brenda vullnetit të ligjvënësit, përjashtimisht masës së shkarkimit nga detyra, për të cilën Kushtetuta ka parashikuar një rregullim të veçantë.

Pikërisht këtë rregullim ndryshe e parashikon neni 147 pika 6 e Kushtetutës, në të cilin masën e shkarkimit e ka trajtuar në mënyrë të posaçme dhe me një garanci më të madhe e në raport me të gjitha masat e tjera disiplinore, duke e lënë shqyrtimin e saj në kompetencë të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Jo pa qëllim Kushtetuta të drejtën e ankimit për masën e shkarkimit nga detyra, si dhe organin që duhet ta shqyrtojë këtë masë e ka parashikuar në pikën 6 të nenit 147, duke e veçuar nga pika 4 e tij, e cila lë në diskrecionin e ligjvënësit trajtimin e rasteve të përgjegjesisë disiplinore të gjyqtarëve.

Njëkohësisht, aspekt tjetër i antikushtetutshmërisë së dispozitës ligjore, objekt i këtij gjykimi, është dhënia e një kompetence ligjore Gjykatës së Lartë, kompetencë që del jashtë juridiksionit të saj kushtetues. Në bazë të nenit 147 pika 6 të Kushtetutës, kundër vendimit të shkarkimit, gjyqtari ka të drejtë të ankohet në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kushtetuta e ka të përcaktuar juridiksionin e Gjykatës së Lartë. Në nenin 141 të Kushtetutës është parashikuar se kjo gjykatë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Gjithnjë sipas kësaj dispozite, asaj i njihet e drejta e njësimi ose e ndryshimit të praktikës gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese nuk shtrihet për shqyrtim interpretimin e zgjeruar kushtetues të juridiksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të parashikuar në nenin 141, përse kohë që çështjen e ankimit ndaj masës së shkarkimit të gjyqtarëve, si dhe organin që shqyrton një masë të tillë, Kushtetuta e ka parashikuar shprehimisht dhe në mënyrë të posaçme në një dispozitë tjetër.

Gjithashtu, Kushtetuta nuk i ka lënë ndonjë hapësirë ligjvënësive që, në kuptim të fuqizimit të standardit të mbrojtjes së gjyqtarëve, të përfshijë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë shqyrtimin e ankimit ndaj masave të tjera disiplinore. Kapërcimi i standardit të mbrojtjes së gjyqtarëve nuk mund të përbëjë argument për të tejkaluar juridiksionin kushtetues të këtij organi.

Çështja e standardeve pozitive është një koncept që përgjithësisht lejohet nga Kushtetuta, por ky nuk mund të ketë shtrirje të pakufizuar, aq më pak për kategorinë e funksionarëve publikë. Neni 17 i Kushtetutës, si dhe qëndrimet e mbajtura nga jurisprudenca gjyqësore pranojnë teorinë e standardit pozitiv kur bëhet fjalë për të drejtat themelore të individit, por jo ndaj zyrtarëve të lartë të shtetit.

Shkarkimi nga detyra i gjyqtarit është një procedurë *impeachment*, e cila zbatohet për zyrtarë që ushtrojnë aspekte të sovranitetit shtetëror dhe, si e tillë, ajo nuk mund të barazohet me procedurën që ndiqet për individët e thjeshtë. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një aspekt të të drejtave të çdo individi, por *“kjo nuk është e drejtë absolute. Ajo mund të jetë subjekt i kufizimeve të ligjshme.”*¹

Sidoqoftë, në këtë drejtim, Kushtetuta ka bërë një hap më tej se Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, duke e shoqëruar masën e shkarkimit të gjyqtarit me garancitë e ankimit në Gjykatën e Lartë. Shtrirja e këtij koncepti edhe për masat e tjera disiplinore bie në kundërshtim me Kushtetutën. Nga ky kuptim, neni 147 pika 6 i Kushtetutës, duke qenë i konceptuar si një dispozitë me karakter përjashtimor, nuk mund të interpretohet në mënyrë zgjeruese.

Mbështetur në këto argumente, neni 34/1 i ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, që zgjeron objektin e ankimit të gjyqtarëve për masat e tjera disiplinore, si dhe juridiksionin e Gjykatës së Lartë, i ka kapërcyer caqet e vendosura nga Kushtetuta. Përderisa ndodhemi përpara një norme ligjore që nuk mbështetet në parimet dhe rregullimet e specifikuar kushtetuese, por në tejkallime jashtëkushtetuese si në formë, ashtu edhe në përmbajtje, Gjykata Kushtetuese çmon se është prekur parimi i hierarkisë së normave. Ky është një qëndrim i konsoliduar i Gjykatës Kushtetuese në disa çështje të tjera analoge, në të cilat ka theksuar se *“atë” që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla...”*²

Mbi bazën e të gjitha argumenteve të parashtruara më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se dispozita objekt shqyrtimi duhet shfuqizuar si antikushtetuese vetëm sa i takon pjesës së saj që parashikon të drejtën e gjyqtarëve për t'u ankuar edhe ndaj masave të tjera disiplinore në Gjykatën e Lartë.

¹ Çështja Devlin kundër Mbretërisë së Bashkuar (vendimi nr.29545/95, datë 30.10.2001 i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

² Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.212, datë 29.12.2002; Përmbledhje e vendimeve, viti 2002, faqe 206.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “a”, 134 pika 1 shkronja “d”, 145 pika 2 të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të shprehjes “*Si dhe për çdo masë tjetër me karakter disiplinor*” në nenin 34/1 të ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit të shumicës. Nuk mendoj se neni 34/1 i ligjit nr.8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, është antikushtetues e duhet të shfuqizohet.

Ashtu si pakica e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, edhe unë jam i mendimit se “tejkalmimi në mënyrë pozitive i standardit kushtetues nëpërmjet nxjerrjes së një ligji që i njeh gjyqtarit të drejtën e ankimit për çdo masë disiplinore, nuk e bën atë antikushtetues. Në argument të kundërt, shumica e Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nuk pranon konkluzionin e mësipërm. Kjo, sipas saj, se Kushtetuta jonë pranon teorinë e standardeve pozitive në raport me të drejtat themelore të individit, por jo ndaj zyrtarëve të lartë të shtetit”. Një qëndrim i tillë vlen të diskutohet. Funksionarët e shtetit gëzojnë një sërë të drejtash individuale kushtetuese që lidhen direkt me qenien e tyre si individë (e drejta për punë, për proces të rregullt, për ankim, etj.). Këtë ka pranuar edhe praktika e Gjykatës Kushtetuese, e cila të drejtën kushtetuese individuale për proces të rregullt ligjor e ka pranuar në raport me funksionarët politikë. Në këto kushte, duke qenë se ankimi është një e drejtë kushtetuese, zgjerimi i tij në kahun pozitiv, kurrsesi nuk mund të jetë shkelje e këtyre të drejtave, e as e frymës së Kushtetutës.

Një interpretim i tillë i zgjeruar i nenit 147 të Kushtetutës i bërë nga vetë ligjvënësi duhet analizuar jo thjesht nga pikëpamja formale si kapërcim i juridiksionit të Gjykatës së Lartë, parashikuar shprehimisht në Kushtetutë. Ai para së gjithash, duhet gjykuar në qëllimin e në pasojat që sjell për rendin juridik, e pastaj mund të pasojnë konsideratat. Edhe sikur ta thjeshtosh problemin në aspektin logjik, unë nuk mendoj se një veprim i konsideruar formalisht si shkelje e Kushtetutës, të mund të sjellë pasoja pozitive lidhur me pozitën e pushtetit gjyqësor në Shqipëri. Në termin praktik, zgjerimi i juridiksionit të Gjykatës së Lartë në shqyrtimin e konflikteve që kanë të bëjnë me pavarësinë, patundshmërinë e paprekshmërinë e gjyqësorit, shkon në sensin pozitiv. Po ta vëresh Kushtetutën e sidomos nenin 17, preokupimi i legjislatorit është kur kufizon të drejtat (prandaj përcakton edhe kriteret bazë) e jo kur atyre u sigurohet një mbrojtje sa më efektive. Për pakicën, mbrojtja efektive duhet të jetë prezent jo vetëm në largimet nga puna, por edhe në rastet e tjera (në dukje disiplinore, por në thelb represive), si transferim për një periudhë njëvjeçare, e sidomos transferimi në një rreth të një kategorie më të ulët (që në terrenin faktik është konvertuar me largim nga puna).

ANËTAR
A.Karamuço

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë: njësive postare të qyteteve;
Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042 555 63; 267 468
www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

**REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR
NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005**

1. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA
2. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE MATERIALE
3. REGJISTRI I TESTAMENTEVE
4. INDEKSI ALFABETIK

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë, Vëllim i II-të, Botim 2005)....	1500
4.	PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1.	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2.	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. KODI DOGANOR
2. KODI DETAR

Doli nga shtypi më 1.12.2005

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë